

**VENDIM**  
**Nr. 641, datë 29.7.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR ZHVILLIMIN E  
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR PROJEKTET “NDËRTIM I  
KAMPUSIT TË RI TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS”, “NDËRTIM I  
GODINAVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS” DHE “NDËRTIM I  
KORPUSIT TË POLICISË SË SHTETIT, POLICISË SHKENCORE DHE  
AKADEMISË SË SIGURISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ministrit të Kulturës, të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e Bashkisë Tiranë, si autoritet kontraktor për të ndërmarrë e zhvilluar procedurat e prokurimit publik për projektet “Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtim i Kampusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë”.

2. Bashkia Tiranë të administrojë procedurat e prokurimit publik për zhvillimin e projekteve, me objekt “Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtim i Kampusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë”.

3. Efektet financiare për zhvillimin e këtyre procedurave përballohen nga buxheti i shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**